

## Gjykata Themelore e Mitrovicës

P 67/2017

### Në emër të popullit

Gjykata Themelore e Mitrovicës në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarëve të EULEX-it: Dariusz Sielicki si kryetar i trupit gjykues, Radostin Petrov dhe Arnout Louter si anëtarë të trupit gjykues, të mbështetur nga zyrtarja ligjore Chiara Tagliani duke vepruar si procesmbajtëse, në rastin penal nr. P 67/2017 kundër:

**Z. V.**, i nacionalitetit serb, qytetar i Republikës së Serbisë,

i akuzuar nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës me Aktakuzën PPS. Nr. 90/2014, e parashtruar në Gjykatë më 16 maj 2017 dhe e plotësuar më 14 maj 2018, me akuzat siç përshkruhet në vijim:

I. gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, më 5 maj 1999, në mes të orës 11:30 -13:30 në V., rruga E. D., duke vepruar në bashkëkryerje me një person tjetër të identifikuar, në cilësinë e rezervistit të policisë serbe, përderisa që të dy mbanin uniformën e policisë dhe ushtrisë serbe dhe ishin të armatosur me thika, pistoleta dhe pushkë automatike; duke vepruar në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi gjatë luftës, duke e shkelur nenin 3 (1a dhe c) i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit, 1949, si dhe duke e shkelur Protokolin shtesë (protokoli II) i kësaj Konvente të vitit 1977, neni 4, pikat 1 dhe 2a dhe 2e;

- a) ai me qëllim ka rrahur dhe pastaj ka vrarë katër civil shqiptarë: E. R., H. F., A. F. dhe F. F., e ka bërë këtë në shtëpinë e familjes F., pas rrahjes dhe plaçkitjes së civilëve të ndryshëm të nacionalitetit shqiptar;
- b) ai me qëllim ka cenuar integritetin trupor, shëndetin, mirëqenien fizike apo mendore të këtyre personave: S. F., F. Sh., V. Xh., Z. Xh., N. Xh., B. Xh., Z. Xh., B. P., L. R., G. M., H. M., G. Sh., A. S., S. Sh., B. O., Sh. O., F. M., A. M., A. M. duke shkaktuar trajtim mizor dhe johuman dhe cenim të dinjitetit njerëzor kundër tyre, duke i rrahur ata me grushta, shkelma dhe objekte të tjera të forta në pjesë të ndryshme të trupit, duke shkaktuar në disa raste shenja apo mavijosje në trup si dhe dhimbje të madhe fizike dhe mendore tek ata, pasojat e të cilave disa prej viktimave i vuajnë edhe sot;
- c) ai me qëllim dhe me dhunë ka plaçkitur para në shuma të ndryshme, ar dhe gjëra të tjera të çmuara nga civilët shqiptarë, konkretisht nga: V. Xh., N. Xh., Z. Xh., B. O., Sh. O., B. M., U. M., F. M., para se të vriste katër civilë shqiptarë: E. Rr., A. F., H. F. dhe F. F.;

përderisa këto veprime janë kualifikuar në Aktakuzë si krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të KP-së të RSFJ-së, që korrespondon me nenin 3 (1a dhe c) i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës, që aktualisht sanksionohet me nenin 152

(1) dhe (2.1) dhe neni 153 (1) dhe (2), në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

pas gjykimit të mbajtur më 11 janar 2018, 6, 7, 8, 13, 15, 20, 21 shkurt 2018, 20, 21, 22, 27, 28, 29 mars 2018 dhe 14, 15 2018 në praninë e të akuzuarit dhe avokatit të tij mbrojtës M. D., dhe përfaqësuesi i palëve të dëmtuara B. M., me palët e dëmtuara: S. F., B. F., F. Sh., M. Rr., A. F. - Sh., A. S., L. R. (H), V. Xh., N. Xh., Z. Xh., B. Xh., B. P., G. M., H. M., B. O., G. Sh., Sh. O., F. M., të informuara në mënyrë të rregullt për datat dhe vendin e të gjitha seancave gjyqësore,

ndërsa B. F., S. F., G. Sh., M. Rr., N. Xh., V. Xh., G. M., A. S. ishin të pranishëm në ditën e 11 janarit 2018, dhe M. Rr., S. F., B. O., Sh. O. ishin të pranishëm më 14 maj 2018, dhe B. O., M. Rr., Sh. O., S. F., B. F. dhe G. Sh. ishin të pranishëm më 15 maj 2018;

pas diskutimit dhe votimit të trupit gjykues i mbajtur më 16 maj 2018 në bazë të nenit 359, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) në praninë e të akuzuarit, avokatit mbrojtës M. D., Prokurorit të EULEX-it të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, Paul Flynn, përfaqësuesit të Palëve të Dëmtuara, shpall publikisht me sa vijon:

#### **AKTGJYKIM**

- I. Në bazë të nenit 364, paragrafi 1, pika 1.3 të KPPRK-së, i akuzuari Z. V. lirohet nga të gjitha akuzat e paraqitura në

pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi sepse nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprat me të cilat ngarkohet ai;

- II.** Në bazë të nenit 463, paragrafi 3, i KPPRK-së, palët e dëmtuara udhëzohen që t'i realizojnë kërkesat pasurore me padi civile;
- III.** Në bazë të nenit 450, paragrafi 2, pika 1-5 të KPPRK-së, shpenzimet e procesit penal dhe shpenzimet e nevojshme dhe kompensimi i avokatit mbrojtës për të pandehurin do të mbulohen nga burimet e buxhetit.

## **ARSYETIMI**

### **I. Konteksti procedural**

1. Më 30 maj 2014, prokurori lëshoi një Aktvendim për inicimin e hetimeve në rastin PPS 90/14 kundër Z. V. për krime lufte kundër Popullatës Civile.
2. Më 16 mars 2016, u pezullua hetimi e pastaj u rihap më 9 mars 2017.
3. Më 11 nëntor 2016 i pandehuri ishte ekstraduar në Kosovë nga autoritetet e M. të Z., pas Vendimit të datës 18 korrik 2016 të Gjykatës së Lartë të P., M. i Z., për miratimin e kërkesës për ekstradim të Z. V. dhe më pas "Vendimi për

ekstradim të të pandehurit Z. V. në Kosovë" i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së M. të Z. më 7 nëntor 2016.

4. Më 16 maj 2017, prokurori ngriti aktakuzën PPS 90/14 kundër të pandehurit për pikat që janë paraqitur në pjesët 1 a, b dhe c të pjesës hyrëse të këtij aktgjykimi.

5. Në bazë të nenit 245 të KPPRK-së, më 4 gusht u mbajt një seancë fillestare. Gjatë seancës, i pandehuri u deklarua si i pafajshëm në të gjitha akuzat. Sipas nenit 245, paragrafi 5 i KPP-së, palët janë ftuar për të bërë parashtresa me shkrim në lidhje me aktakuzën.

6. Më 4 shtator 2017, avokati mbrojtës me kohë parashtroi një Kërkesë për hedhjen poshtë të aktakuzës.

7. Më 14 shtator 2017 prokurori me kohë parashtroi Përgjigje në Kërkesat për të hedhur poshtë aktakuzën.

8. Avokati mbrojtës argumentoi që:

a) është kundër arsyes dhe logjikës për të suposuar që brenda tri ditësh të konfliktit të armatosur intensiv dhe bombardimit të vazhdueshëm që një person të ketë kryer të gjitha veprimet kriminale të supozuara;

b) përgjegjësia penale e të akuzuarit nuk është treguar qart në aktakuzë pasi që nuk është specifikuar "se kush është vrarë saktësisht nga i akuzuari";

c) dyshimi i bazuar mirë mungonte pasi që rasti i prokurorisë mbështetej vetëm në deklaratat e dëshmitarëve dhe

deklaratat e tilla përmbajnë elemente kundërthënëse që paraqesin dyshime sa i përket kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve. Për më tepër, nuk është paraqitur asnjë dëshmi tjetër relevante materiale nga prokurori;

9. Më 14 shtator 2017 Prokurori me kohë parashtroi ankesë në Kërkesat për hedhjen poshtë të aktakuzës.

10. Me aktvendimin e datës 30 shtator 2017, kryetari i trupit gjykues e hodhi poshtë Kërkesën për ta hedhur poshtë aktakuzën e parashtruar nga avokati mbrojtës si e pabazuar dhe i shpalli të gjitha provat e propozuara nga prokurori si të pranueshme.

11. Nuk pati asnjë ankesë në këtë Aktvendim.

## **II. Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e trupi gjykues**

1. Në përputhje me nenin 11, paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199, gjykata themelore ka jurisdiksion për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha veprat penale.

2. Krimet e paraqitura në aktakuzë janë kryer në V. që ndodhet në territorin nën kompetenca të Gjykatës Themelore të M.. Prandaj, në përputhje me nenin 29, paragrafi 1 i KPPRK-së, kjo gjykatë ka jurisdiksion territorial për ta gjykuar rastin.

3. Në bazë të nenin 286 të KPPRK-së gjykimi duhet të mbahet në vendin ku e ka selinë gjykata dhe në ndërtesën e gjykatës.

4. Më 23 qershor 2017, pas kërkesës së parashtruar nga autoritetet kompetente të EULEX-it, në përputhje me nenin 3.5 dhe 3.6 të "Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës" - Ligji nr. 05/L-103 të 17 qershorit 2016, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) lëshoi një vendim duke e caktuar një gjyqtar të EULEX-it si kryetar të trupit gjykues për këtë rast.
5. Më 8 shtator 2017, KGjK-ja lëshoi një vendim tjetër ku theksohet që "rasti penal nr. P. nr. 67/2017 (PPS 90/2014) do të gjykohet nga trupi gjykues i përbërë prej gjyqtarëve të EULEX-it dhe i kryesuar nga një gjyqtar i EULEX-it".
6. Nga palët nuk u ngrit asnjë çështje në lidhje me përbërjen e trupit gjykues. Prandaj, pohohet se në bazë të nenit 382, paragrafi 4 të KPPRK-së ata kanë hequr dorë nga kontestimi i përbërjes (së trupit gjykues).

### **III. Shqyrtimi kryesor**

#### **1. Kohëzgjatja e shqyrtimit kryesor**

a) Shqyrtimi kryesor filloi më 11 janar 2018 dhe përfundoi më 16 maj 2018. Ai përbëhej prej 17 ditë gjykimi.

b) Për shkak të gjatësisë së dëshmive të dëshmitarëve për prokurorinë, kohëzgjatja e shqyrtimit kryesor e ka tejkaluar periudhën prej 120 ditësh kalendarike të paraparë me nenin 314, paragrafi 1.2 të KPPRK-së. Çdo ndërprerje e mëpastajme e caktuar nga trupi gjykues

nuk e ka tejkaluar 30 ditë me përjashtim të ndërprerjes së caktuar më 29 mars 2018 që ka zgjatur deri më 14 maj 2018, e që ka qenë për shkak të përfshirjes së anëtarëve të trupit gjykues në një rast tjetër penal kundër të akuzuarit. Ndërprerjet përherë janë arsyetuar duke paraqitur veprimet procedurale që duhej të ndërmerren gjatë seancës së radhës.

c) Palët nuk kanë ngritur kundërshtime sa i përket kohëzgjatjes të ndërprerjeve në mes të seancave gjyqësore, as sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit. Prandaj, në bazë të nenit 382, paragrafi 4 i KPPRK-së është supozuar se ata kanë hequr dorë nga kontestimi i kësaj çështjeje.

## 2. Prania e palëve

a) Prokurori i EULEX-it i PSRK-së, i akuzuari dhe avokati i tij mbrojtës ishin të pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore.

b) Palët e dëmtuara janë informuar për gjykimin dhe për të drejtat e tyre procedurale, si dhe se gjykimi mund të mbahet në mungesë të tyre, por ato nuk i kanë ushtruar të drejtat e tyre si palë gjatë gjykimit. Palët e dëmtuara janë paraqitur në gjykatë gjatë këtyre ditëve:

- Më 11 janar 2018: B. F., S. F., G. Sh., M. Rr., N. Xh., V. Xh., G. M., A. S.;
- Dhe më 14, 15 dhe 16 maj 2018: M. Rr., B. F., S. F., B. O., Sh. O..

## 3. Gjuha e procedurës, përkthimi dhe procesmbajtja



- a) Bazuar në nenin 16 të Ligjit për Jurisdiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjuha e përdorur në procesin gjyqësor ishte anglishtja.
- b) Në përputhje me nenin 1, paragrafi 2 i KPPRK-së, përkthyesit kanë përkthyer procesin gjyqësor dhe të gjitha dokumentet e gjykatës relevante për gjykimin, nga anglishtja në shqip dhe serbisht dhe anasjelltas. Gjatë dy ditëve të para të gjykimit, përkthimi në gjuhën serbe i është ofruar publikut. Në ditët tjera nuk është kërkuar përkthimi në serbisht nga publiku. Përkthyesi i serbishtes është ulur pranë të akuzuarit dhe avokatit mbrojtës në të gjitha ditët e gjykimit për për të përkthyer për ata. Shumica e përkthimit është ofruar në mënyrë konsektive. Nga folësit kryetari i trupit gjykues ka kërkuar për të bërë ndërprerje gjatë gjatë parashtrimeve të tyre, zakonisht nga 1 deri në 3 minuta dhe si parim në fund të mendimit të plotë, dhe pastaj përkthyesi e ka thënë atë në gjuhën e caktuar. Kjo metodë ua mundësonte palëve për të kontrolluar saktësinë e përkthimit të të gjitha dëshmimeve të dhëna në gjykatë.
- c) Në disa raste palët kanë ngritur kundërshtime sa i përket cilësisë së përkthimit. Të gjitha kundërshtimet janë shqyrtuar menjëherë nga trupi gjykues dhe sqarimi është vendosur në procesverbal.
- d) Fjala përmbyllëse e palëve dhe shpallja e dispozitivit të aktgjykimit janë përkthyer simultan në anglisht, shqip dhe serbisht.
- e) Në bazë të vendimit të kryetarit të trupit gjykues që është marrë në bazë të nenit 315, paragrafi 2 dhe 5 të KPPRK-së më 11 janar 2018, procesverbali është bërë fjalë për fjalë me shkrim dhe pa audio, video ose stenografi

sepse koha e shfrytëzuar për përkthim i ka lejuar procesmbajtësit që me saktësi të kap dhe shënojë të gjitha fjalët e thëna në gjykatë.

- f) Saktësia e procesverbalit me shkrim është kontrolluar nga kryetari i trupit gjykues në kohë reale. Monitori i kompjuterit duke e paraqitur procesverbalit është vendosur para atij. Kjo mënyrë e procesmbajtjes shfrytëzoi metoda tjera të procesmbajtjes të panevojshme pasi që nuk dukej të kishte mundësi për të arritur ndonjë saktësi më të madhe të përmbajtjes semantike të procesverbalit. Nuk kishte kundërshtime sa i përket saktësisë së procesverbalit.

#### 4. Parimet e zbatuara për marrjen në pyetje të dëshmitarëve

- a) Si parim, pyetjet sygjestive gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë nuk u lejuan nga kryetari i trupit gjykues. Përrjashtimet e vetme që ishin lejuar kur kujtimi i fakteve nga një dëshmitar ishte zbehur në mënyrë të qartë, kur kishte nevojë për të fokusuar vëmendjen e dëshmitarit në një çështje të caktuar, ose kur pyetje kishte të bënte me një çështje që pa dyshim ishte e njohurisë së përgjithshme. Po ashtu pyetjet provokative, sygjestive dhe përsëritëse nuk u lejuan në këtë fazë.
- b) Ngacmimi apo ofendimi i një dëshmitari si dhe keqcitimi i deklaratave, nuk është lejuar gjatë marrjes në pyetje.
- c) Trupi gjykues aktivisht ka marrë pjesë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve në faza të ndryshme të marrjes në pyetje. Megjithatë, palëve përherë iu ka dhënë mundësia për të sfiduar përgjigjet e dhëna nga dëshmitari në përgjigje të pyetjes së gjyqtarit. Trupi gjykues e bazoi

marrjen në pyetje të dëshmitarëve në konkluzionin që neni 7, paragrafi 1 i KPPRK-së obligon gjyqtarët për të kërkuar të vërtetën objektive. Prandaj, ishte i nevojshëm një qartësim i hollësishëm i të gjitha çështjeve faktike që për gjyqtarët dukej të ishte i paqartë. Pasi që neni 299, paragrafi 1 i KPPRK-së i jep të drejtën gjyqtarëve për të bërë pyetje secilit dëshmitar por nuk tregon ndonjë fazë të caktuar të marrjes në pyetje trupi gjykues mori qëndrimin se kodi nuk vendos ndonjë kufizim sa i përket kohës së marrjes në pyetje nga gjyqtarët.

## 5. Propozimet për prova të palëve

a) Të gjitha propozimet për prova të prokurorit, si 'Propozimi për njoftim gjyqësor të fakteve të gjykuara' dhe 'Propozimi për prova të reja për t'u pranuar gjatë gjykimit', janë miratuar dhe provat e propozuara janë shpallur si të pranueshme dhe janë shqyrtuar gjatë gjykimit.

b) Propozimi i datës 28 gusht 2017 i parashtruar nga avokati mbrojtës për të marrë në pyetje dëshmitarët: V. M. V., Z. J., T. T., S. T., V. J., Lj. S., D. P., dhe D. J. ishte pranuar. Megjithatë, dëshmia e propozuar doli të jetë e pasigurueshme pasi që lokacioni i saktë i secilit prej dëshmitarëve mbeti i panjohur për trupin gjykues përkundër përpjekjeve të bëra për t'i siguruar ato përmes ndihmës së autoriteteve kompetente serbe pasi që siq duket dëshmitarët jetonin në Serbi. Prandaj, në bazë të nenit 258, paragrafi 3, më 14 maj 2018, trupi gjykues i shpalli këto dëshmi si të përjashtuara nga provat pasi që nuk ishte e mundshme që ato të shqyrtohen në gjykatë.

## 6. Provat e shqyrtuara nga trupi gjykues

a) Janë dëgjuar nga trupi gjykues këta dëshmitarë të propozuar nga prokurori:

- B. F. më 6 shkurt 2018;
- G. M. më 7 shkurt 2018;
- H. M. më 7 shkurt 2018;
- A. F. Sh. më 8 shkurt 2018;
- B. O. më 13 shkurt 2018;
- dhe Sh. O. më 13 shkurt 2018;
- F. M. më 15 shkurt 2018;;
- G. Sh. më 20 shkurt 2018;
- M. Rr. më 20 shkurt 2018;
- A. S. më 21 shkurt 2018;
- S. F. më 21 shkurt 2018;
- F. Sh. më 20 mars 2018;;
- V. Xh. më 21 mars 2018;
- N. Xh. më 21 mars 2018;
- Z. Xh. më 22 mars 2018;
- B. Xh. më 22 mars 2018;
- B. P. më 27 mars 2018;
- L. H. më 27 mars 2018;
- F. I. më 28 mars 2018;
- S. K. më 29 mars 2018;

b) Më 6 mars 2018, Prokurori e tërhoqi dëshmitarin I. J..

c) Me pëlqimin e palëve gjatë seancës së 22 marsit 2018, dëshmia e dëshmitarit T. R. u konsiderua si e lexuar.

d) Me propozim të prokurorit u prezantua këto dëshmi para trupit gjykues dhe u përfshin në prova:

a. fotografi:

- fotot ajrore të vendit të krimit (ref: 1999-00285) të 21 janarit 2004
- pesë fotografi të vendit të ngjarjes të regjistruara nën nr. BI 2017-18-99, të datës 26 tetor 1999

- shtatë fotografi të varreve të A. F., F. F., H. F. and E. Rr.

b. raportet e autopsisë:

- të trupit të F. Sh., datës 22 gusht 2000, nr. HR 36/001B;
- të trupit të A. Sh., date 22 gusht 2000, nr. HR 37/001B;
- të trupit të E. Rr., i datës 21 gusht 2000, nr. HR 10/001B;
- të trupit të H. Sh., i datës 21 gusht 2000, nr. HR 11/001B;

c. dokumente të tjera:

- Dëshmia e zingjirit të ruajtjes me numrin e dosjes 04-227, datës 13.01. 2004;
- Raporti i ekspertizës balistike, data 7 shkurt 2004, dosja nr. 2004 - 04 - 227 dhe Referenca ballistike nr.: B040077.
- Fotoalbumi i datës 16 janar 2004, dosja MHQF# 04 - 227 (34 fotografi)
- Raporti teknik i Kriminalistikës dosja nr. #04-227- duke përfshirë 2 skica të vendit të ngjarjes të datës 11 shkurt 2004,
- Kartelat për të dhënat e letërnjoftimit- e kaluara e personave të lartëpërmendur: H. F. ne nr., F. F. me nr., A. F. dhe E. Rr. me nr..
- Certifikata nga Drejtorati për Administratë dhe Personel i datës 13.04. 2012 për H. F..
- Raporti i vendit të ngjarjes i datës 13 prill 2017, fotoalbumi i bashkëngjitur me 17 foto.

d. certifikatat e vdekjes:

- E. Rr.- nr., ,
- F. F.- nr., ,
- A. F. - nr.,
- H. F.- nr.,

e. procesverbali i identifikimit të një personi në fotoalbum:

- nga S. F., datës 08 shkurt 2016
- nga B. F., datës 08 shkurt 2016
- nga N. Xh., datës 10 shkurt 2016
- nga S. K., datës 08 shkurt 2016
- nga B. Xh., datës 27 mars 2017

f. Harta e Rr. D. në V. me shenjat e bëra nga dëshmitari B. F. gjatë marrjes në pyetje në shkurt 2018, së bashku me hartën korresponduese A4, është shenjuar si Prova materiale 1 dhe është shqyrtuar nga trupi gjykues.

g. Një copë letër me nënshkrimin e dëshmitarit G. M. është shtuar si Prova materiale 2 më 7 shkurt 2018.

d). i akuzuari vendosi të deklarohej dhe deklarata e tij është dëgjuar në gjykatë më 15 maj 2018.

#### **IV. Përcaktimi i gjendjes faktike**

1. Faktet relevante për pikat për të cilat akuzohet i akuzuari në këtë rast janë vërtetuar nga trupi gjykues si rezultat i analizës dhe vlerësimit të të gjitha provave të shqyrtuara në gjykatë. Trupi gjykues ka vërtetuar se:

a. Më 5 maj 1999 në mes të orës 11.30 dhe 2.30 pas dite, G. P. dhe një tjetër person i paidentifikuar i nacionalitetit rom është shfaqur në afërsi të Rr. E. D. në V. që banohej nga popullatë shqiptare. Që të dy kishin veshur rroba të stilit ushtarak. G. P. iu ka drejtuar burrit tjetër si "S.", "S." ishte më i gjatë

se G. P. dhe dukej topolak. Ata ishin të armatosur me pushkë automatike, pistoletë dhe thika.

- b. Dy burrat hynë në shtëpinë e familjes M. dhe kërkuan para nga G. M. dhe H. M. që ishin të pranishëm aty. G. M. dhe H. M. refuzuan që t'u japin diçka sepse ata nuk kishin para dhe këta dy burra i rrahën ata dhe i shkelmuan ata në tërë trupin për rreth 20-25 min dhe mëpastaj ata shkuan në oborrin e shtëpisë së F. S.. Pas kësaj G. P. dhe "S." shkuan tek shtëpia e I. M..
  
- c. Në atë oborr G. P. dhe burri tjetër takuan dy gra të reja. Njëra prej grave po mbante një fëmijë në duart e saj. G. P. e kapi fëmijën dhe u përpoq ta merrte nga gruaja por ajo rezistoi. Pas kësaj dy burrat u larguan në drejtim të shtëpisë që i takon A. S..
  
- d. Ata iu afruan shtëpisë dhe u përpoqën të hyjnë përmes derës kryesore por ajo ishte e kyçur. Ata takuan Q. S. në rrugë dhe e morën atë në hyrjen e prapme të shtëpisë dhe e detyruan atë që ta thyejë derën atje. G. P. dhe Q. S. hynë në shtëpi. "S." qëndroi jashtë por pas pak iu bashkangjiti G. P.. Ata qëndruan për pak kohë në shtëpi duke kërcënuar A. S. se do ta vrisnin. "S." ia gërvishi me thikë qafen e A. S..
  
- e. Ishte një grup i refugjatëve që kishte qëndruar në shtëpinë e I. M. për disa ditë. Ata ishin larguar nga fshati i tyre i lindjes për shkak të operacioneve ushtarake të forcave serbe që kishin shkuar atje. G. P. dhe "S." plaçkitën një qafore dhe disa stoli tjera ari në vlerë prej 4500 DM nga A. F. - Sh., 1000 DM nga B. M. dhe 700 DM nga U. M.. Ata e bënë këtë duke i kërcënuar këta persona me përdorim të forcës vdekjeprurëse dhe në këtë mënyrë i detyruan ata që të dorëzojnë paratë dhe gjërat e vlefshme. Njëkohësisht ata cenuan integritetin trupor të F. M. duke e goditur atë me një armë automatike në shpinë dhe A. M. duke e kapur atë për hunde dhe duke e goditur me shuplakë.

Ata po ashtu e kërcënuan A. M. që ishte 7 vjeçar, se do t'ia këputnin kokën duke ia vënë një thikë në fyt.

- f. Pastaj ata shkuan tek shtëpia e S. C.. Ata atje takuan F. F. dhe e morën atë me vete në shtëpinë e B. O..
- g. Aty ishin Sh. O., B. O., G. Sh. dhe të moshuar të tjerë dhe fëmijë. G. dhe "S." kërkuan para prej tyre. "S." vizatoi një kryq në ballin e Sh. O. e kur ajo e fshiu atë ai e goditi atë me shuplakë disa herë. Pastaj, ai e detyroi G. Sh. që të zhvishej duke ia vënë thikën në fyt dhe pistoletën në gojë. Kur nuk gjeti para, ai e rrahu G. Sh.. Pas kësaj Sh. Sh. i dha atij 300 DM. Pastaj "S." dhe G. P. u larguan duke i urdhëruar banorët e asaj shtëpie për t'u shtrirë në dysheme dhe për t'i mbajtur duart e tyre prapa koke. Ata e morën me vete F. F. dhe shkuan tek shtëpia e F..
- h. Në shtëpinë e H. F., "S." dhe G. P. kërkuan para prej personave që ishin të pranishëm aty duke i kërcënuar ata me përdorimin e armëve. Ata e goditën disa herë S. F. dhe F. Sh.. "S." e goditi F. Sh. me dorezë të pushkës së tij. Gratë u detyruan që të lëpijnë gjakun nga shuplakat e agresorëve. Njëri prej agresorëve e hodhi A. F. në dysheme. Pak më pas E. Rr. dhe H. F. erdhën në shtëpi. Agresorët diskutonin me zë të lartë se kë të vrisnin të parin. Pastaj G. P. shtiu në gjoksin e E. Rr.. Pastaj "S." shtiu në A. duke e goditur atë në gjoks, e G. shtiu në kokën e H. F. dhe në gjoksin e F.. E. R., H. F. dhe F. F. vdiqën menjëherë ndërsa A. F. vdiq një orë më vonë.
- i. Agresorët u larguan nga shtëpia e H. F.. Ata e takuan L. R. dhe një grua tjetër jashtë dhe i detyruan ato që të hyjnë me ata në shtëpinë e V. Xh.. "S." e mori letërnjoftimin nga V. Xh., e bëri copa dhe e detyroi V. Xh. që ta hante atë. Pastaj, ai e kapi një djalë me emrin E. dhe kërcënoi që ta lëndonte atë me një thikë nuk atij nuk i jepeshin para. Z. Xh. i dha "S." 2000



DM. Mëpastaj, agresorët cenuan integritetin trupor të disa personave: Z. Xh. duke e grushtuar atë me grusht në kokë, N. Xh. duke e goditur atë me bishtin e thikës, B. Xh., duke e goditur atë disa herë në fytyrë, Z. Xh., duke e goditur shuplakë në një pjesë të papërcaktuar të trupit dhe B. P., duke e shkëlmuar atë në fytyrë dhe duke e goditur atë në kokë me dorezë të thikës. Ata i terrorizuan viktimat me kërcënim të përdorimit të armës dhe plaçkitën 1200 DM nga ata dhe në fund u larguan.

Z. V. nuk ka marrë pjesë në asnjërin prej veprimeve kriminale që janë pjesë të këtij procesi. Kjo gjetje u bazua në këtë vijë të arsyetimit: dëshmitari B. F. kishte hetuar kryesit duke lëvizur nga një lokacion në tjetrin. Përrjashtohet mundësia që ka pasur ndonjë person tjetër që e ka shoqëruar G. P. në shtëpinë e A. S. dhe që ishte bashkëkryes i akteve të tjera kriminale.

2. Pasi nuk është vërtetuar që pjesëmarrja e Z. V. në aktet kriminale, trupi gjykses nuk e ka të nevojshme që të elaborojë detajet e veprimeve të caktuara të bëra nga kryesit në secilin prej lokacioneve të caktuara. Detajet e tilla nuk do të kontribuonin në identifikimin e Z. V. si kryes pasi që nuk është vërtetuar prania e tij në vendin e ngjarjes.

## **V. Vlerësimi i provave**

1. Trupi gjykses gjeti në përgjithësi të besueshme të gjitha dëshmitë e dhëna në gjykatë nga dëshmitarët e ndjekjes.

Thënë në përgjithësi, versionet e tyre të ngjarjeve ishin logjike, koherente dhe e vërtetonin njëra-tjetrën. Ky vlerësim ka të bëjë me rrëfimet e ngjarjeve të prezantuara nga dëshmitarët por jo me njohjen nga ata e Z. V. si njëri prej kryesve.

a. Kishte divergjenca dhe dallime në lidhje me disa detaje të vogla. Ato kryesisht kishin të bënin me përshkrimin e veshjes të agresorëve dhe disa herë në radhitjen e veprimeve të tyre. Është mendim i trupit gjykues që këto divergjenca dhe dallime ishin rezultat i kalimit të kohës dhe të metave të natyrshme të perceptimit dhe kujtesës së njeriut. Në fakt, ata e siguruan trupin gjykues se dëshmitë e dhëna para trupit gjykues ishin plotësisht spontante dhe nuk ishin sajuar paraprakisht nga dëshmitarët.

b. Në lidhje me të gjithë dëshmitarët, reagimet e tyre kur u ballafaquan me dallimet dukeshin spontane dhe të natyrshme. Sqarimet e tyre në lidhje me detajet e pyetura gjatë marrjes në pyetje në gjykim u vlerësuan nga trupi gjykues si të sigjerta dhe bindëse. Duhet të theksohet se marrja në pyetje gjatë hetimit të kryer nga TNJ nuk ishin shumë specifike. Procesverbali tregon se nuk janë bërë pyetje për qartësim në atë kohë. Prandaj, mospërputhjet nuk e vunë në dyshim kredibilitetin e dëshmitarëve.

2. Nuk kishte dyshime sa i përket besueshmërisë së S. K.. Megjithatë, dëshmia e tij ishte e dobishme vetëm për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve okularë pasi që i referohet deklaratave që i janë dhënë atij nga personat e tjerë. Në veçanti, dëshmia e tij nuk ka mund të shfrytëzohej për identifikimin e Z. V. si kryes pasi që ishte e bazuar në thashetheme të paverifikueshme.

3. Dëshmia e dhënë nga T. R. ishte plotësisht e besueshme pasi që i akuzuari nuk e ka kontestuar atë.
  
4. Të gjitha dokumentet e propozuara nga prokurori janë vlerësuar si autentike dhe të besueshme sa i përket përmbajtjes së tyre pasi që ato nuk u kontestuan nga mbrojtja dhe nuk kishte arsye për t'i mospërfillur ato.
  
5. Trupi gjykues gjeti se dëshmia e A. S. të jetë plotësisht e besueshme jo vetëm në lidhje me rrjedhën e veprimeve që kanë ndodhur në shtëpinë e tij por po ashtu edhe në lidhje me identifikimin e fajtorëve. Dëshmia e A. S. ka shërbyer si bazë për gjetjen e trupit gjykues se Z. V. nuk ka qenë kryesi e veprimeve që janë pjesë e procesit.
  - a) Nuk kishte elemente që do të paraqisnin kritikë në vërtetësinë e A. S.. Dëshmitari paraqiti një vëzhgim shumë të mirë dhe aftësi raportuese që janë tipike për trajnimin dhe profesionin e tij si zyrtar policor.
  
  - b) Rrëfimi i tij i ngjarjeve jashtë shtëpisë, sidomos lokacioni i agresorëve dhe mënyra se si ata kanë hyrë në shtëpinë e tij është në përputhje me detajet e përshkruara nga B. F.. A. S. në mënyrë të vendosur e ka mohuar që Z. V. ishte e pranishëm në shtëpinë e tij dhe që prandaj të ishte njëri prej kryesve. Ai i njohu dhe i identifikoi të dy ata. Ai në mënyrë të vendosur deklaroi që njëri prej agresorëve ishte G. P.. Kjo njohje është në përputhje me deklaratën e B. F.. Në të njëjtën kohë A. S. e njohu dhe e identifikoi kryesin tjetër si burrë i nacionalitetit rom që G. P. në kohën kritike iu kishte drejtuar si "S.". Në bazë të dëshmitarit, ai e kishte

parë "S." në disa raste para ngjarjes së ndodhur në shtëpinë e tij.

- c) Besueshmëria e A. S. u vërtetua përmes marrjes në pyetje të tërthortë të hollësishme dhe të kujdesshme jo vetëm nga prokurori por edhe nga anëtarët e trupit gjykues. Të gjitha përgjigjet e tij ishin logjike dhe koherente. Dëshmitari nuk tregoi prirje që me qëllim të shmang ndonjë detaj. Ai në të vërtetë ishte plotësisht i hapur.
- d) A. S. u ballafaqua me deklaratën e tij të dhënë më 9 shkurt 2016 në lidhje me përshkrimin e dukjes së "S." kur ai ka thënë që "S. kishte vënë një qorapë në fytyrë dhe kokë." Kjo trupit gjykues si kundërthënie e konsiderueshme në raport me deklaratën e tij të dhënë në gjykatë ku dëshmitari ka raportuar që "S." e kishte fytyrën të pambuluar. Reagimi i A. S. në këtë kundërthënie ishte autoritativ dhe dukej të ishte i singert dhe bindës. Ai dukej se nuk ishte i hutuar aspak dhe fuqishëm insistoi se "S." e kishte fytyrën të pamaskuar.
- e) Duhet të theksohet se gjatë marrjes së parë në pyetje nga hetuesi i TNJ-së më 28 tetor 2004 dëshmitari qart ka deklaruar se nga dy kryesit vetëm G. P. mbante maskë, që përputhet me dëshminë e tij në gjykatë. Më 9 shkurt 2016 dëshmitari e ka përshkruar se "S." kishte flokë të shkurta dhe të zeza që qart nuk është në përputhje me deklaratën se "S." kishte një qorapë në kokë dhe fytyrë pasi që flokët e tij nuk mund të shiheshin. Trupi gjykues theksoi se marrja në pyetje ka zgjatur nga ora 10.40 deri në 13.30 dhe është bërë në shqip, duke mos lejuar kohë për përkthim. Procesverbali është bërë nga zyrtari hetues dhe ka më pak se tri faqe të tekstit të shënuar me kompjuter. Supozohet se procesverbali i marrjes në pyetje është në fakt vetëm një përmbledhje e deklaratës së

dëshmitarit dhe jo fjalë për fjalë. Edhe pse kjo është një mënyrë normale dhe plotësisht e pranueshme të marrjes së procesverbalit gjatë një hetimi, ka shumë të ngjarë që mund të ndodhë shtrembërimi i paqëllimshëm i procesverbalit. Leximi dhe nënshkrimi i procesverbalit nga dëshmitari i intervistuar nuk e eliminon rrezikun e shtrembërimit. Prandaj, kjo mospërputhje nuk rezulton në mohimin e kredibilitetit të A. S..

f) A. S. e njihte Z. V. para lufte. Ai takohej me të në gjykatë ku punonte Z. V.. A. S. shkonte atje gjatë kryerjes së detyrave si polic për ta dërguar postën në gjykatë. Ai thoshte se e ka takuar Z. V. "njëqind herë". Kryesit kanë qëndruar për një kohë të caktuar në shtëpinë e tij. Kjo ia ka dhënë atij mundësinë për të vëzhguar të dy ata direkt dhe nga një distancë e vogël. Njohja e kryesve nga ai bazohej në baza të fuqishme dhe për këtë arsye u konsiderua nga trupi gjykues si i besueshëm dhe vendimtar.

6. Njohja dhe identifikimi i Z. V. si kryes nga të gjithë dëshmitarët tjerë në rast nga trupi gjykues është vlerësuar si e dyshimtë, jobindëse prandaj edhe e pabesueshme. Prandaj, deklaratat relevante të dëshmitarëve që pretendonin ta njihnin Z. V. tashmë në kohën kritike apo më vonë, dmth, gjatë fotorreshtimit, nuk mund të eliminonin dyshimet sa i përket pjesëmarrjes së Z. V. në kryerjen e krimit, dyshime që buronin nga deklaratat e A. S.. Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 i KPPRK-së dyshimet u dasht të interpretohet në favor të të akuzuarit.

7. Sa i përket deklaratës së A. S., trupi gjykues përfundoi se njohja e Z. V. nga personat e tjerë që pretendonin ta kenë njohur atë para lufte ishte i gabuar. Megjithatë, kundërthënie në mes tyre dhe A. S. sa i përket njohjes nuk

ishte faktori i vetëm dhe ekskluziv që ka kontributuar në këtë konkluzion. Në veçanti:

a) B. F. pretendonte ta ketë njohur Z. V. që prej kohës kur që të dy ata e kanë shkuar në shkollën fillore. Kur është pyetur nga prokurori se kur e ka parë Z. V. për herë të fundit para 5 majit 1999, dëshmitari spontanisht u përgjigj: "nuk e kam parë Z. V. deri në ditën kur kanë ndodhur këto vrasje, por e kam parë G. P. dy ditë më parë, e kam parë atë në shtëpinë e axhës tim." Vetëm pasi që i është përsëritur përgjigjja, dëshmitari tha që e ka parë Z. V. kur ka shkuar në gjykatë për të paguar një gjobë dhe ka qenë dita kur kanë ndodhur masakrat në L. dhe Ç.. Edhe pse dëshmitari pretendoi se ato kanë ndodhur në vitin 1999 është fakt i njohur se masakrat kanë ndodhur në mars 1998. Trupi gjykues theksoi se për shkak të dallimin prej 4 vjetër në moshë në mes të B. F. dhe Z. V., dëshmitari nuk ka qenë më shumë se 11 vjeç kur i akuzuari është larguar nga shkolla. Është fakt i njohur se shkollimi në nivel të shkollës fillore në Jugosllavi ka filluar në moshën 7 vjeçare dhe ka zgjatur 8 vite. Prandaj, mbamendja e të akuzuarit nga B. F. si shok shkolle duket të jetë shumë i largët në kohën e njohjes së të akuzuarit të bërë në 1998 dhe pastaj në ditën kritike mund të bazohet vetëm në gjasime të zbehta pasi që në fakt i referohet personit që dëshmitari e ka takuar si shok klase rreth 12 vite më herët. Për më tepër, B. F. vazhdonte të vëzhgonte kryesit dhe në të njëjtën kohë vraponte dhe fshihej prej tyre. Mundësia e tij për t'i parë ata dhe për t'i njohur ata nuk ishte po aq direkte se ajo e A. F..

b) Njohja e Z. V. e paraqitur nga A. F. Sh. doli të jetë dukshëm e pabesueshme. Dëshmitarja deklaroi se ajo e takoi Z. V. derisa ai punonte si nëpunës gjykate në vitin 1984 ose 1985 dhe se ai dukej i rritur. Z. V. ka lindur

më 1970 kështu që ai nuk ka mundur të ketë filluar të punojë në gjykatë në atë kohë.

c) Trupi gjykues erdhi në përfundim se njohja e Z. V. si fajtor nga fotorreshtimi nga persona që nuk e kanë njohur atë para ditës kritike dhe kurrë nuk e kanë takuar atë më pas nuk mund të konsiderohet si dëshmi e besueshme. Vetëm S. F. i është prezantuar një fotoalbum relativisht shkurt pas kohës kritike. Deklarata e saj në identifikimin e të akuzuarit u vlerësua nga trupi gjykues si jo konkluzive për shkak të dyshimeve që dalin nga këto baza:

a. Imazhi që shfrytëzohet për fotorreshtim tregonte vetëm fytyrën e të dyshuarit duke shikuar përpara pa e treguar profilin e tij. Nuk bartte ndonjë informacion për strukturën e trupit, lartësinë. Nuk mundësonte për përceptimin e karakteristikave të tilla sikurse gjatësia e hundës ose prognathizmit. Rezolucioni dhe qartësia e imazhit ishte e dobët pasi që ishte fotokopje e fotografisë origjinale. Nuk lejonte për të parë lartësinë e eshtrave të fytyrës. Nuk përshkruante ndonjë tipar unik të fytyrës ose shenja dalluese. Burimi i saj ishte nga letërnjoftimi i Z. V. dhe ishte bërë disa vite para kohës kritike. Imazhi lejonte vetm të përceptohej thjesht një gjasim i personit të përshkruar me dukjen reale dhe nuk tregonte tipare që mund të përjashtonin identifikimin e gabuar. Krijonte rrezikun e identifikimit pozitiv të të akuzuarit vetëm për shkak të gjasimit të tij të përgjithshëm me kryesin aktual.

b. Metoda e shfrytëzuar për prezantimin e fotoalbumit quhet radhitje simultan. Fotot i janë treguar secilit dëshmitar në grup. Është e qartë se dëshmitarët e përfshirë në krahasimin e imazheve dhe prandaj në gjykim relativ. Qartazi krijoi rrezikun që ata e kanë

zgjedhur atë që më së shumti i ka ngjarë fajtorit në krahasim me të tjerët, duke u mbështetur në rezultatet e krahasimit dhe jo vetëm në kujtesën e tyre.

d) N. Xh. pretendoi të kishte njohur pak Z. V. para lufte. Ai e njohu Z. V. nga fotoja vetëm më 10 shkurt 2016. Atij i është prezantuar i njëjti fotoalbum duke përfshirë një foto të të akuzuarit më 12 dhjetor 2004 dhe ai nuk ka qenë në gjendje ta njohë të akuzuarin. Për më tepër, atë kohën ai deklaroi që agresori që ka ardhur në shtëpinë e tij me G. P. ishte i njohur si "D.". Për shkak të këtyre kundërthënive dhe dallimeve deklarata e tij në lidhje me njohjen e të akuzuarit u konsiderua si jo e besueshme.

e) B. Xh. e njohu Z. V. si fajtor nga fotografia vetëm më 4 prill 2017. Në atë kohë ai nuk e identifikoi G. P. edhe pse A. S. më 28 tetor 2004, N. Xh. më 12 dhjetor 2004, V. Xh. më 3 shkurt 2016 dhe H. M. më 4 prill 2017 pretenduan se e njohën G. P. por jo fajtorin tjetër. Për shkak të kësaj njohje selektive, kalimit të kohës dhe faktit që B. Xh. i ka parë fajtorët për një kohë relativisht të shkurtër, deklarata e tij për njohjen e Z. V. u konsiderua si jobindëse.

f) Asnjë dëshmitar tjetër nuk e njohu Z. V. nga fotorreshtimi gjatë rrjedhës së hetimeve.

g) Disa dëshmitarë pretenduan ta kenë njohur Z. V. në gjykatë. Trupi gjykses përfundoi se identifikimi në gjykatë nuk kishte vlerë provuese. Duke e prezantuar një person si i akuzuar në gjykatë bart rrezikun që të ketë efekt dukshëm paragjykses në dëshmitarin pasi që i



akuzuari është personi i vetëm për t'u identifikuar. Në anën tjetër, identifikimi negative në gjykatë mund të shfrytëzohet si provë shfajësuese. Prandaj, të gjitha deklaratat e dëshmitarëve për njohjen e Z. V. si kryes për trupit gjykues ishin dukshëm jobindëse.

- h) Trupi gjykues nuk mund të mbështetet në njohjen e të akuzuarit nga një deklaruues që nuk ishte në dispozicion për të dëshmuar në gjykim. Në bazë të deklaratës së Sh. O., A.S. i ka thënë asaj se ai e ka njohur Z. V. në kohën kritike. Deklarimi i tij përbënte thashetheme të paverifikueshme dhe për këtë arsye nuk ka pasur vlerë provuese.

## **VI. Aktgjykimi**

### 1. Përshkrimi i akuzave

- a) Trupi gjykues përfundoi se përshkrimi i akuzave të paraqitura në aktakuzë përcjell informata të mjaftueshme dhe në fakt të sakta për fushështirirjen e akuzimit, dmth, në veprimet e të akuzuarit, vendin dhe kohën e tyre, dhe viktimat që janë lënduar nga ato. Megjithatë, përshkrimi është dhënë në mënyrë përmbledhëse dhe narrative dhe përbëhej prej elementeve që nuk i përkasin karakteristikave të krimeve me të cilat akuzohej i akuzuari. Për qëllim të qartësisë dhe saktësisë, krimet për të cilat është akuzuar Z. V. janë paraqitur në pjesën hyrëse të aktgjykimit në mënyrë të strukturuar dhe me heqjen e elementeve të panevojshme për kualifikim juridik.

- b) Ka qenë detyrë e trupit gjykues për të hequr emrin e kryesit tjetër, atë të G. P., nga përshkrimi i akuzave kundër Z. V. në pjesën hyrëse të dispozitivit.

Përfshirja e emrit të një personi që nuk ka marrë pjesë në gjykim në dispozitiv si bashkëkryes do të shkelte parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën për gjykim të drejtë. Prezumimi nuk lejon që në aktakuzë të përfshihen emra të bashkëkryesve të paakuzuar për të shmangur njollosjen e padrejtë të personave të tillë. Megjithatë, është një praktikë e vendosur përgjithësisht në gjykatat nacionale në BE që lejon përmendjen e emrit të bashkëkryesit në arsyetimin e aktgjykimit për hir të qartësisë së prezantimit të fakteve të vërtetuara gjatë gjykimit. Përmendja e tillë nuk konsiderohet paragjykyese për ndonjë proces tjetër penal dhe ka shumë më pak të ngjarë për ta njollosur personin e përmendur se sa ajo që është në dispozitiv.

2. Në bazë të nenit 364 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i KPPRK-së, ishte e detyrueshme për ta liruar nga akuzat Z. V. sepse nuk është dëshmuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej.
3. Trupi gjykues e bazoi vendimin e tij në lidhje me shpenzimet e procesit penal në dispozitat juridike të cituara në dispozitiv.

---

**Dariusz Sielicki**  
**Kryetari i trupit gjykues**

---

**Chiara Tagliani**

## Procesmbajtëse

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës brenda (15) ditësh nga pranimi i kopjes së aktgjykimit, në përputhje me nenin 380 paragrafi (1) i KPP-së.